



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 134/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Therandë, paraqitur kundër subjektit Nisma për Kosovën dega në Therandë, për shkak të vendosjes së posterave, për Zgjedhjet e Përgjithëshme në Republikën e Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 06.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (VV), dega në Therandë kështu që subjektit politik Nisma për Kosovën, dega Therandë i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 700 (shtatëqind) euro të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 04.06.2014, Lëvizja Vetëvendosje (VV), ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se, me datë 04.06.2014, në ora 11:00 aktivistët e LVV – së kanë vërejtur se në fshatin Shirokë – Komuna e Therandës ishte vendosur poster i kandidatit për Kuvendin e Kosovës Haxhi Shala nga subjekti Nisma për Kosovën mbi shenja të komunikacionit . Për këtë, në kuptim të dispozitës së nenit 4.1 pika (b) të Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013 vendosja e posterëve mbi shenja të komunikacionit përbënë veprim të ndaluar për subjektet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre. Sipas kësaj, subjekti politik Nisma për Kosovën me vendosjen e posterit (banerit) ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 4.1 pika (b) të Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në cilësi të provës parashtruesi i ankesës ka ofruar dy fotografi .

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik- Nisma për Kosovën-, me datën 05.06.2014, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 06.06.2014 deri në ora 10:00.

PZAP-i, pranoi përgjigjen në ankesë sipas afatit të caktuar .

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e bazuar

Nga fotografit e ofruara si prova të cilat gjinden në shkresat e lëndës shihet qartë se posterët e kandidatit për Kuvendin e Kosovës Haxhi Shala të subjektit politik Nisma për Kosovën janë vendosur mbi shenja të komunikacionit në fshatin Shirokë Komuna e Therandës, veprim ky i cili është në kundërshtim me dispozitën e nenit 33 pika (b) të LZP-së të cilat përcaktojnë veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, që ndalon vendosjen e posterëve në shenjat publike të trafikut.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe

PZAP-i, mori parasysh rrethanat lehtësuese ngase subjekti në fjalë, pas marrjes së Kërkesës për dhënien e Përgjigjes në ankesë për të Ndërmarr Masa Përmirësuese, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes duke e larguar postërin nga vendi ku pretendohet se ka ndodhur shkelja e supozuar.

PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura konstatoi se subjekti NISMA për Kosovën ka rënë në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1 pika b) të Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, i cili parasheh se *"Është e ndaluar vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve në shenjat publike të trafikut ose vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në apo mbi rrugët publike gjatë fushatës zgjedhore"*.

Duke marrë parasysh se subjekti NISMA për Kosovën pas pranimit të Kërkesës për Përgjigje në ankesë dhe Urdhrit për të Ndërmarr Masat Përmirësuese nga PZAP-i, subjekti në fjalë menjëherë ka larguar posterat e theksuar në ankesë, që nënkupton se është bërë evitimi i shkeljes së supozuar në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura në përgjigje e të cilat veprime kanë ndikuar si rrethana lehtësuese në shqiptimin e gjobës, duke u bazuar se subjekti i lart cekur merë pjesë për hërë të parë në Zgjedhjet në Kosovë. Andaj në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 134/2014 më datën 06.06.2014.

Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*